

UDHËZIM

Nr.1456/2, datë 29.9.2009

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.1456, DATË 28.7.2009 "PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LICENCIM, TË SUBJEKTEVE QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË PËRKUJDESIT SHOQËROR"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 18 pika 1 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të pikës 5 kreu II dhe pikës 4 kreu XI të vendimit nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta" të Këshillit të Ministrave,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.1456, datë 28.7.2009 të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta "Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të përkujdesit shoqëror", pas germës "a" të pikës 3, shtohet germa "a/1" me përmbajtjen si më poshtë vijon:

"a/1.shqyrton dokumentet provuese për drejtuesin teknik, sipas përcaktimit të germës "a", pika 2, kreu III i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta", si: diplomën universitare në degët mjekësi, ekonomi dhe shkenca sociale, apo diploma masteri të nivelit të dytë në këto degë."

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE

DHE SHANSEVE TË BARABARTA

Spiro Ksera